



Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo



Komuna Hani i Elezit  
Municipality of Hani i Elezit

02.Nr 688 / 2020

Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Republikës së Kosovës nr 03/L-040 neni 13 mbi aktet e Kryetarit të Komunës dhe nenin 58 Përgjegjësitë e kryetarit ,gjithashtu bazuar në Ligjin Nr.04L-175 Për inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit neni 15 dhe neni 17, si dhe pas shkresës së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nr 4677-2/19 të datës 25.07.2019, Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit merr këtë:

#### V E N D I M

**Mbi transferimin e pozitës Inspektor i Ndërtimit nga DUKMM në DSHPE**

1. Tranferohet pozita e “**Inspektorit të ndërtimit**” nga Drejtoria e Urbanizmit, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit në Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Emergjencë në komunën e Hanit të Elezit

2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

#### ARSYETIM

Pas pranimit të shkresës nr 4677-2/19 të MMPH-së, me anë të së cilës pas vizitës inspektuese në Drejtorinë e Urbanizmit, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit nga inspektorati i MMPH-së është konstatuar se pozita e inspektorit të ndërtimit është në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe bazuar në legjislacionin në fuqi kjo është konflikt interesi pasi që inspektori i ndërtimit i përgjigjet organit kompetent d.m.th drejtorit të Urbanizmit, andaj kryetari i komunës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi/

**Vendimi t’u dërgohet:**

- Kryetarit të Komunës,
- Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë
- Zyrës së Personelit dhe
- Arhivës.

Data :29.01.2020  
Hani i Elezit

  
**Kryetari i Komunës**  
**Rufia Suma**